



Informacione për pjesëmarrësit në kurse integrimi

për qytetarë të huaj që jetojnë prej kohësh në Gjermani, për qytetarë me të drejtë pjesëmarrjeje, për qytetarë me pjesëmarrje të detyruar që kanë emigruar kohët fundit për në Gjermani.

Të dashur qytetarë,

sipas ligjit për lejeqëndrimin ju keni të drejtën të merrni pjesë njëherë në një kurs integrimi ose ju jeni i detyruar që të merrni pjesë në një kurs integrimi.

Cfarë është një kurs integrimi?

Kursi i përgjithshëm i integritit përbëhet nga një kurs gjuhe me 600 orë mësimi si dhe një kurs orientimi me 45 orë mësimi. Kursi i gjuhës përbëhet nga faza dhe çdo fazë ka përkatësisht 100 orë . 300 orët e para do të quhen kursi bazë i gjuhës, ndersa 300 orët e tjera do të jenë kurs më i zgjeruar i gjuhës.

Në kursin e gjuhës ju mësoni një fjalor, i cili ju nevojitet për të folur dhe shkruar në jetën e përditshme. Në këtë aspekt bëjnë pjesë komunikimi me institucionet zyrtare, biseda me fqinjët dhe kolegët e punës, shkrimi dhe formulimi i letrave si dhe plotësimi i formularëve.

Kursi i orientimit ju informon juve mbi jetën në Gjermani si dhe ju jep njohuri mbi rendin juridik, kulturën dhe historinë e vendit.

Ka edhe kurse speciale integrimi p.sh. për gra, prindër, të rinj si dhe për persona të cilët nuk dinë mirë të shkruajnë dhe të lexojnë. Këto përbëhen nga 945 orë mësimi. Në qoftë se ju mësoni shpejt, atëherë ju mund të bëni një kurs intensiv. Ky kurs përbëhet nga 430 orë mësimi.

Se cili kurs dhe cila fazë është më e përshtatshme për ju për të filluar kursin përcaktohet nga organizatori i kursit ma anën e një provimi (testi) para fillimit të kursit.

Pjesëmarrja në provimin (testin) përfundimtar

Provimi (testi) përfundimtar përbëhet nga një provim gjuhe dhe testi në kursin e orientimit. Në qoftë se ju në provimin e gjuhës dispononi njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane dhe e merrni provimin (testin) e kursit të orientimit, atëherë ju e keni përfunduar me sukses kursin e integritit dhe merrni dëshminë e kursit të integritit „Zertifikat Integrationskurs“. Në qoftë se ju nuk e mbaroni me sukses provimin (testin), atëherë juve ju jepet një vërtetim me rezultatin e arritur.

Pjesëmarrja në provimin (testin) përfundimtar është pa pagesë.

Avantazhet e pjesëmarrjes ne kursin e integrimit

Të huajt, të cilët vijnë nga një shtet i cili nuk bën pjesë në Bashkimin Europian duhet të plotësojnë disa kushte në qoftë se ata duan të marrin një leje të pakufizuar (përherëshme) qëndrimi në Gjermani. Përveç të tjerash ata duhet të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane, njohuritë bazë të rendit (shtetit) juridik, shoqërisë gjermane si dhe të mënyrës së jetesës në Gjermani. Me përfundimin me sukses të kursit të integrimit ju i keni përmbushur kushtet e mësipërme. Përveç kësaj ju mund të merrni më shpejt shtetësinë gjermane.

Përveç kësaj njohuritë e marra në kursin e integrimit ju lehtësojnë jetën e përditshme në Gjermani si dhe i rrisin shanset tuaja në tregun e punës.

Pranimi në kursin e integrimit nga zyra federale dhe rregjistrimi tek organizatori i kursit

Ju lutemi, plotësoni kërkesën (formularët) me një shkrim të qartë e të lexueshëm. Ju mund t'i drejtoheni edhe ndonjë organizatori të kursit, i cili mund t'ju ndihmojë në plotësimin e kërkesës. Pastaj dergoni kërkesën në zyrën përkatëse të zyrës federale rajonale.

Në qoftë se ju pranoheni të merrni pjesë ne kursin e integrimit, atëherë ju do të njoftoheni me anën e një vërtetimi me shkrim nga zyra federale. Nj kohësisht ju do të merrni një listë me organizatorët e kursit, të cilët organizojnë kurse integrimi në afërsi të vendbanimit tuaj.

Fletëpranimi në kursin e integrimit është i vlefshëm për dy vite. Në vërtetimin e pranimi është dhënë një datë, dhe deri në këtë datë ju duhet të shkoni tek një organizator kursi që të rregjistroheni. Ju lutem, rregjistrohuni sa më shpejt të jetë e mundur duke i paraqitur organizatorit të kursit vërtetimin e pranimi.

Organizatori i kursit duhet t'ju tregojë juve përafërsisht se kur fillon ndonjë kurs. Kursi nuk duhet të fillojë më vonë se tre muaj nga dita e rregjistrimit. Në qoftë se në këtë kohë nuk organizohet ndonjë kurs, atëherë organizatori i kursit duhet t'ju informojë ju për këtë. Ju mund të vendosni vetë, a dëshironi të prisni apo të rregjistroheni tek një tjetër organizator kursi. Në këtë rast organizatori i kursit duhet t'ju kthejë juve vërtetimin e pranimi.

Rregullat e pjesëmarrjes

Në mënyrë që ju ta arrini qëllimin e kursit të integrimit, duhet që ju të merrni pjesë rregullisht në të. Kjo do të thotë që ju duhet të merrni pjesë rregullisht në mësim si dhe në provimin (testin) përfundimtar. Pjesëmarrja rregullisht në kurs është edhe për ju me rëndësi, në qoftë se juve ju paguhen shpenzimet e udhëtimit ose në qoftë se më vonë dëshironi të përsërisni kursin më të përparuar. Organizatori ju vërteton me shkrim pjesëmarrjen tuaj në kurs, në qoftë se ju e dëshironi një gjë të tillë.

Shpenzimet e kursit të integrimit

Ju duhet t'ju paguani organizatorit të kursit 1€ (1EURO) për orë mësimi. Kjo shumë duhet të paguhet në çdo fillim faze 100 orëshe të kursit dhe para fillimit të kursit të orientimit. Në qoftë se ju mungoni në mësim, atëherë nuk ju paguhet shuma për orët e humbura të mësimi. Në qoftë se ju nuk keni të ardhura financiare, atëherë shumën e kërkuar duhet ta paguajë personi i cili është përgjegjës për ju.

Ju mund të çliroheni nga pagesa, në qoftë se ju trajtoheni nga shteti me paratë e papunesisë II (Arbeitslosengeld II), trajtoheni me ndihmë sociale (Sozialhilfe) ose me që ju fitoni shumë pak nuk jeni në gjendje të paguani. Kërkesën për perjashtim nga pagesa ju duhet ta bëni me shkrim tek zyra

federale rajonale, e cila është përgjegjëse për ju (shiko listën e adresave). Vërtetimin me arsyet e përjashtimit nga pagesa dorëzoheni të bashkëngjitur me kërkesën (një kopje të vërtetimit përkatës).

Ju lutem, bëni shtrimin e kërkesës në momentin e regjistrimit tek organizatori i kursit. Në qoftë se ju jeni përjashtuar nga pagesa, atëherë ju duhet të informoni menjëherë nëse nuk trajtoheni më me paratë e papunësisë II apo me ndihmë sociale, apo kushtet tuaja financiare kanë ndryshuar.

Mbulimi i shpenzimeve

Në qoftë se ju pas datës 08.12.2007 keni kaluar me sukses provimin (testin) përfundimtar, atëherë zyra federale mund t'ju kthejë 50% të shpenzimeve të bëra. Kjo vlen vetëm në rastin kur ndërmjet të lëshimit të drejtes për pjesëmarrje në kurs dhe datës së provimit (testit) përfundimtar nuk kanë kaluar me shumë se dy vite. Për kthimin e shpenzimeve ju duhet të bëni një kërkesë tek zyra rajonale federale përkatëse.

Shpenzimet e udhëtimit

Shpenzimet e nevojshme të udhëtimit do t'ju kthehen juve, nëse ju se jeni të liruar nga pagesa e shpenzimeve apo merrni paratë e papunësisë II nga zyra përkatëse e cila ju ka detyruar që të merrni pjesë në një kurs integrimi. Për detyrim në pjesëmarrje nga ana e zyrës për të huaj, mundeni ju gjatë nevojës të pranoni një ndihmë në të holla për shpenzimet e udhëtimit.

Në të gjitha rastet duhet ju të bëni një kërkesë në zyrën federale, ku do të arsyetoni shpenzimet e udhëtimit. Parimisht shpenzimet e udhëtimit mbulohen nga zyra federale vetëm në qoftë se ju merrni pjesë rregullisht në kurs.

Përseritja e kursit përgatitor të gjuhës

Në qoftë se ju në provimin e gjuhës nuk dëshmoni njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane, atëherë ju mund ta përsërisni kursin përgatitor edhe njëherë duke bërë edhe 300 orë mësimi. Si kusht për këtë është që ju të keni marrë pjesë rregullisht në mësim si dhe në provimin përfundimtar.

Pjesëmarrja në kursin përgatitor pas orëve të përseritura është pa pagesë.

Në qoftë se ju dëshironi ta përsërisni kursin përgatitor, atëherë duhet të bëni një kërkesë tek zyra federale.

Udhëzime për një pjesëmarrje të detyruar

Në qoftë se ju jeni i detyruar nga zyra e të huajve apo nga zyra e punës (që ju paguan paratë e papunësisë II) që të merrni pjesë në një kurs integrimi, atëherë sa më shpejt që të jetë e mundur ju duhet të regjistroheshi tek një organizator i një kursi integrimi dhe të merrni pjesë rregullisht në këtë kurs. Në qoftë se ju nuk e bëni një gjë tillë kjo mund të ketë pasojat mëposhtme për ju:

- Kjo mund të ndikojë në vendimin për zgjatjen e lejes së qëndrimit.
- Në qoftë se ju trajtoheni (merrni) me ndihmë sociale, ajo mund t'ju shurtohet.
- Eventualisht mund t'ju kërkohet nga zyra e të huajve që shumën prej 1 EURO për orë mësimi ta bëni me parapagim për të gjithë kursin e integritimit në formën e një pagese.
- Mund të bëhet vendosja e ndonjë gjobe.

Organizatori juaj i kursit duhet të informojë zyrën e të huajve ose zyrën e punës (ku merrni paratë e papunesisë II), në qoftë se ju nuk merrni pjesë rregullisht në kursin e integrimit.

Cfarë duhet të dini ju

Të gjithë formularët që u përmendën në këtë fletëudhëzues ju do t'i merrni nga organizatori i kursit tek zyra e të huajve ose tek zyra federale rajonale. Përveç kësaj formularët ju mund t'i gjeni në faqen e internetit www.integration-in-deutschland.de.

Ju lutem merrni në konsideratë zyrën e keshillimit të emigrantëve(MEB) si dhe zyrën e keshillimit për të rinj. Këto institucione ju ndihmojnë në plotësimin e formularëve, i përgjigjen pyetjeve tuaja, kujdesen për problemet tuaja si dhe mund të gjejnë për ju një kurs integrimi të përshtatshëm. Se ku ndodhen institucionet e mësipërme zyra e këshillimit të emigrantëve si dhe zyra e keshillimit për të rinj, ju mund ta mësoni një gjë të tillë tek zyra juaj e të huajve, tek zyra federale rajonale ose në faqen e internetit: www.integration-in-deutschland.de.